



SHPALLJE E KONKURSIT PËR POZITËN

PËRKTHYES PROFESIONAL SHQIP-ANGLISHT SERBISHT

Departamenti:	Administratë dhe Financa
Raporton te:	Udhëheqësi i Departamentit të Administratës dhe Financave
Vendi i punës:	Prishtinë
Niveli i pagës:	450 euro
Orari i punës:	I Plotë
Kontrata:	Një vjeçare, me mundësi të vazhdimit

FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI I POZITËS

Përkthyesi bën përkthimin me shkrim të materialeve dhe dokumenteve si dhe përkthimin simultan gjatë takimeve nga gjuha Angleze në atë Shqipe/Serbe dhe anasjelltas për nevojat e ZRRUM-it. Poashtu, fushëveprimi i aktiviteteve të kësaj pozite përfshinë edhe administrimin e materialeve për përkthim dhe raportimin për punën e kryer.

Për punën e vet Përkthyesi i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Seksionit për Administratë dhe Financa.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Bën përkthimin me shkrim të materialeve dhe dokumenteve si: rregulloret, rregullat, ligjet, broshurat, raportet e mediave, komunikatat për shtyp, shkresat etj;
- Bën interpretimin simultan në takimet zyrtare, konferenca, seminare e të ngjashme;
- Mban bazën e të dhënave të informacioneve lidhur me përkthimet e bëra;
- Asiston në përgatitjen e shkresave në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze;
- Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës kur kjo të kërkohej nga eporët e tij të drejtpërdrejt.

KUALIFIKIMET

- Diploma universitare në gjuhë angleze është e preferueshme;
- Njohuri e shkëlqyeshme në të folur dhe të shkruar e gjuhës shqipe, angleze, dhe serbe;
- Përvojë relevante e punës si përkthyes në përkthim shqip-serbisht-anglisht dhe anasjelltas;
- Njohja e punës me kompjuter duke përfshirë *Word* dhe punën me tabela në *Excel*;
- Aftësi të theksuara komunikimi;
- Aftësi për të punuar nën presion dhe të jetë i orientuar në rezultate;
- Aftësi të punojë me efikasitet në mjedis multi-etnik.

DATA E FUNDIT PËR DORËZIMIN E APLIKIMEVE: 22 MARS 2010

Formulari për aplikim mund të merret pranë Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur duke shkruar mbi të titullin e Postit në adresën e poshtë shënuar:

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Rr. Ferat Dragaj. 68, Bregu i Diellit Prishtinë (prapa furrës Qerimi 1)

Tel. +381 38 249 165 110;112 www.wwro-ks.org

DO TË KONTAKTOHEN VETËM KANDIDATËT QË HYJNË NË LISTEN E NGUSHTË